



## **Doktorspiele oder sexuelle Übergriffe?**

### **Lojëra me doktor apo sulme seksuale?**

### **Tipps für Mütter und Väter, Pädagoginnen und Pädagogen**

### **Këshilla për nënat dhe baballarët, pedagoget dhe pedagogët**

#### **Was sind Doktorspiele?**

#### **Çfarë janë lojërat me doktor?**

Doktorspiele gehören zur normalen Entwicklung von Kindern im Vor- und Grundschulalter. Bereits Babys entdecken ihren eigenen Körper – zunächst Haut und Mund, mit wenigen Monaten ihre eigenen Geschlechtsorgane. Sie berühren ihre Vagina (Scheide) oder ihren Penis und genießen die damit verbundenen Gefühle.

Etwas ältere Mädchen und Jungen mögen es, nackt zu sein, sich in Gegenwart anderer auszuziehen und finden zum Beispiel heraus, dass sie durch Berührung und Reibung ihrer Geschlechtsorgane sich schöne Gefühle machen können.

Zwischen dem dritten und vierten Lebensjahr beginnen Mädchen und Jungen, andere in ihre sexuellen Handlungen einzubeziehen. Sie zeigen

die eigenen Geschlechtsorgane und untersuchen sich selbst und ihre gleichaltrigen Freundinnen und Freunde. Sie haben Begriffe für die Geschlechtsorgane und erleben sich selbst als Mädchen oder Junge.

Lojërat me doktor bëjnë pjesë në zhvillimin normal të fëmijëve në moshën parashkollore dhe atë të shkollës fillore. Që kur lindin, foshnjat nisin të zbulojnë trupin e tyre – në fillim lëkurën dhe gojën, pas disa muajve organet e tyre seksuale. Ata prekin vagjinën ose penisin e tyre dhe kënaqen me ndjenjat që lidhen me to.

Kur rriten pak, vajzave dhe djemve ju pëlqen të qëndrojnë lakuriq, të zhvishen në praninë e të tjerëve dhe zbulojnë, për shembull, se duke fërkuar organet e tyre seksuale, mund të përjetojnë ndjenja të bukura. Aty midis moshës tre dhe katër vjeç, vajzat dhe djemtë fillojnë të përfshijnë të tjerët në veprimet e tyre seksuale. Ata tregojnë organet e tyre seksuale dhe ekzaminojnë veten dhe moshataret dhe moshatarët e tyre. Mësojnë termat e organeve të tyre, përjetojnë veten si vajzë apo djalë.

Ab dem vierten Lebensjahr finden Dottorspiele meist in Form von Arztspielen oder Vater-Mutter-Kind-Spielen statt. Die Mädchen und Jungen untersuchen ihre Geschlechtsorgane, imitieren das Verhalten von Erwachsenen (Händchen halten, knutschen, heiraten) und spielen Zeugungs- und Geburtsszenen.

Duke filluar nga mosha katër vjeç, lojërat me doktor, më së shumti, zhvillohen në formën e lojërave me mjek ose lojëra babai-mamaja-fëmija. Vajzat dhe djemtë ekzaminojnë organet e tyre seksuale, imitojnë sjelljen e të rriturve (i kapin dorën njëri-tjetrit, përkëdhelen, martohen) dhe luajnë skena të dëshmitarit të martesës dhe të lindjes.

Im Alltag ist nicht selten zu beobachten, dass bereits Kinder im Vorschulalter orale Handlungen am Penis, an der Scheide oder am Anus nachspielen/ausprobieren. Auch auf Fotos präsentieren sich einige Kinder mit sexuell getönten Posen. Ein solches Verhalten ist kein altersentsprechendes Verhalten.

So wie einige Mädchen und Jungen aufgrund ihrer kindlichen Neugierde mal auf die heiße Herdplatte packen und sich dabei die Finger verbrennen, stecken sich Kinder auch Gegenstände in die eigenen Körperöffnungen und die anderer Mädchen und Jungen. Ihnen ist zum Beispiel nicht bewusst, dass es zu unbeabsichtigten Verletzungen kommen kann, wenn sie im Rahmen von Dottorspielen Stifte oder andere Dinge in die Vagina (Scheide) und in den Anus (Po) stecken.

Në rutinën e përditshme jo rrallë vërehet që edhe fëmijët në moshë parashkollore kopjojnë/provojnë veprime orale në penis, në vagjinë ose

në anus. Edhe në foto disa fëmijë prezantohen me pozime që kanë tone seksuale. Një sjellje e tillë nuk është një sjellje që lidhet me moshën. Ashtu si disa vajza dhe djem, të shtyrë nga kurioziteti, kapin me dorë vatrën e nxehtë të sobës dhe djegin gishtat, ata fusin sende në vrimat e trupit të tyre dhe të vajzave dhe djemve të tjerë. Ata nuk janë të vetëdijshëm, për shembull, se kjo gjë pa dashje mund t'i lëndojë, nëse gjatë lojërave me doktor ata fusin lapsa apo sende të tjera në vagjinë (zog) dhe në anus (prapanicë).

Doktorspiele sind Kinderspiele. Sie werden unter Kindern gleichen Alters oder gleichen Entwicklungsstandes mit maximal zwei Jahren Altersunterschied gespielt. Mädchen und Jungen betrachten und berühren sich gegenseitig. Es sind gleichberechtigte und gegenseitige Spiele. Die Initiative geht dabei nicht nur von einem Kind aus. Kein Kind ordnet sich einem anderen unter. Sie finden eher unter Freundinnen und Freunden als unter Geschwistern statt.

Lojërat me doktor janë lojëra për fëmijë. Ato luhen ndërmjet fëmijëve të së njëjtës moshë ose të të njëjtit stad zhvillimi me një ndryshim moshe prej maksimumi dy vjetësh. Vajzat dhe djemtë sodisin dhe preken ndërmjet tyre. Këto lojëra janë lojëra të barabarta dhe reciproke. Nisma për këtë nuk merret vetëm nga një fëmijë i vetëm. Asnjë fëmijë nuk i nënshtrohet dikujt tjetër. Më shumë luhen ndërmjet shoqeve dhe shokëve sesa ndërmjet motrave dhe vëllezërve.

### **Reaktionen auf Doktorspiele**

Viele Mütter und Väter reagieren verunsichert auf Doktorspiele unter Kindern. Einigen Erwachsenen ist die Beobachtung peinlich. Sie sehen bewusst oder unbewusst weg. Andere haben Angst, auf Doktorspiele positiv zu reagieren. Sie sind in Sorge, Mädchen und Jungen würden bei positiven Reaktionen ein zu starkes Interesse an Sexualität entwickeln. Wiederum andere vernachlässigen aus falsch verstandener Offenheit die Vermittlung klarer Regeln für Doktorspiele.

Mädchen und Jungen brauchen eindeutige Regeln, um im Doktorspiel ihre eigenen persönlichen Grenzen vertreten und die Grenzen der anderen Kinder wahrnehmen und achten zu können.

### **Reagime ndaj lojërave me doktor**

Shumë nëna dhe baballarë reagojnë të pasigurt ndaj lojërave me doktor që luajnë fëmijët. Për një të rritur, e soditura është diçka e turpshme. Ata i largojnë sytë në mënyrë të qëllimshme ose të paqëllimshme. Të tjerët kanë frikë të reagojnë pozitivisht ndaj lojërave me doktor. Ata shqetësohen se vajzat dhe djemtë do të zhvillonin një interes tepër të fortë ndaj seksualitetit nëse do të kishte reagime pozitive. Nga ana tjetër,

ka disa të tjerë që, për shkak të kuptimit të gabuar në lidhje me të folurit e hapur, neglizhojnë të japin rregulla të qarta për lojërat me doktor.

Vajzave dhe djemve u nevojiten rregulla të qarta, që të mund të përfaqësojnë kufijtë e tyre personalë në lojëra me doktor, si dhe për të kuptuar dhe respektuar kufijtë e fëmijëve të tjerë.

## **Regeln für Doktorspiele**

- Jedes Mädchen/jeder Junge bestimmt selbst, mit wem sie/er Doktor spielen will.
- Mädchen und Jungen streicheln und untersuchen einander nur so viel, wie es für sie selber und die anderen Kinder schön ist.
- Alle sind vorsichtig. Kein Mädchen/kein Junge tut einem anderen Kind weh!
- Niemand steckt einem anderen Kind etwas in den Po, in die Scheide, in den Penis, in die Nase, in den Mund oder ins Ohr.
- Größere Kinder, Jugendliche und Erwachsene haben bei Doktorspielen nichts zu suchen.
- Hilfe holen ist kein Petzen!

## **Rregullat për lojërat me doktor**

- Çdo vajzë/djalë e vendos vetë se me kë dëshiron të luajë dokoreshë/doktorë.
- Vajzat dhe djemtë e gudulisin dhe ekzaminojnë njëri-tjetrin vetëm në atë masë sa të jetë e pëlqyeshme për ta dhe për fëmijët e tjerë.
- Të gjithë janë të kujdesshëm. Asnjë vajzë/djalë nuk e lëndon një fëmijë tjetër!
- Asnjë fëmijë nuk u fut të tjerëve diçka në prapanicë, në vagjinë, në penis, në hundë, në gojë ose në vesh.
- Fëmijët e mëdhenj, të rinjtë dhe të rriturit nuk kanë çfarë kërkojnë në lojërat me doktorë.
- Të kërkosh ndihmë nuk do të thotë të spiunosh!

## **Sexuelle Übergriffe durch Kinder**

Sexuelle Übergriffe sind sexuelle Handlungen, die wiederholt, massiv und/oder gezielt die persönlichen Grenzen anderer verletzen. Ein Mädchen oder ein Junge ist sexuell übergriffig, wenn sie/er

- andere Kinder zu sexuellen Handlungen überredet, verführt oder besticht,
- sexuelle Handlungen mit körperlicher Gewalt oder Drohungen erzwingt

- oder andere Kinder wiederholt und/oder gezielt an den Genitalien verletzt.

Einmalige unbeabsichtigte Verletzungen bei kindlichen Doktorspielen sind noch kein Grund für allzu große Besorgnis. Treten jedoch wiederholt Verletzungen auf und missachten Mädchen und Jungen die ihnen bekannten Regeln für Doktorspiele, so ist dieses Verhalten als sexuell übergriffig zu bewerten.

### **Sulme seksuale nga fëmijët**

Sulmet seksuale janë veprime, të cilat, në mënyrë të përsëritshme, masive dhe/ose me qëllim, shkelin kufijtë personalë të të tjerëve. Një vajzë apo djalë po sulmon seksualisht nëse ajo/ai

- bind, josh ose magjeps fëmijët e tjerë për veprime seksuale,
- detyron kryerjen e veprimeve seksuale nëpërmjet dhunës ose kërcënimeve,
- ose, në mënyrë të përsëritur dhe/ose me qëllim, i lëndon fëmijët e tjerë në organet gjenitale.

Lëndimet që ndodhin vetëm një herë dhe në mënyrë të paqëllimshme gjatë lojërave me doktor nuk janë një arsye për t'u shqetësuar shumë. Por, nëse lëndimet shfaqen në mënyrë të përsëritur dhe vajzat dhe djemtë nuk i respektojnë rregullat e njohura për lojëra me doktor, atëherë kjo sjellje duhet vlerësuar si sulm seksual.

Keinesfalls ist wiederholt oder gezieltes sexuell übergriffiges Verhalten eine Folge eines zufällig beobachteten Geschlechtsverkehrs. Einige sexuell übergriffige Kinder waren zuvor selber Opfer sexueller Gewalt. Die meisten von ihnen haben diese Gewalterfahrungen jedoch nicht innerhalb, sondern außerhalb der Familie erlebt. So gilt zum Beispiel unter Jungen sexuell übergriffiges Verhalten oftmals als „Mutprobe“ – zum Beispiel: jüngere oder schwächere Kinder auf dem Klo belästigen oder mit pornografischen Bildern auf dem Handy schocken.

Oftmals hat sexuell übergriffiges Verhalten auch andere Ursachen. Zum Beispiel:

- emotionale Vernachlässigung,
- Vernachlässigung klarer Regeln für Doktorspiele innerhalb der Kindergruppe,
- körperliche Gewalterfahrungen in und außerhalb der Familie,
- Mobbing-Erfahrungen
- oder Zeugenschaft von (häuslicher) Gewalt.

Një sjellje me sulme seksuale të përsëritura ose të qëllimshme nuk është në asnjë mënyrë pasojë e një akti seksual të vërejtur rastësisht. Disa fëmijë që sulmojnë seksualisht më përpara kanë qenë vetë viktimë të dhunës seksuale. Megjithatë, shumica prej tyre i kanë përjetuar këto eksperiencë dhune jo brenda familjes, por jashtë saj. Kështu, për shembull, sjelljen e sulmit seksual djemtë e quajnë shpesh si "provë guximi" – për shembull: ngacmimi i fëmijëve më të dobët kur ata janë në banjë ose lebetitja e tyre duke dërguar foto pornografike në celular.

Shpesh, sjellja e sulmit seksual ka edhe shkaqe të tjera. Për shembull:

- neglizhencë emocionale,
- neglizhenca e rregullave të qarta për lojërat me doktorë brenda grupit të fëmijëve,
- eksperiencë të dhunës fizike në dhe jashtë familjes,
- eksperiencë presioni nga turma
- ose dëshmi të dhunës (në familje).

### **Betroffene Mädchen und Jungen sind Opfer!**

Für viele Mädchen und Jungen sind sexuelle Gewalterfahrungen durch gleichaltrige und ältere Kinder extrem belastend. Deshalb bezeichnet man von sexuellen Übergriffen betroffene Mädchen und Jungen als Opfer.

Sexuell übergriffigen Kindern wird man jedoch weder menschlich noch fachlich gerecht, wenn man sie als „Täter“ oder „Täterin“ kriminalisiert und ihre Handlungen als „Missbrauch“ bezeichnet. Fachleute sprechen deshalb von „sexuell übergriffigen Kindern“. Im Alltag ist es wichtig, dass die Eltern der betroffenen und der übergriffigen Kinder sich nicht gegenseitig beschuldigen und die Kinder aus dem Blick verlieren.

### **Vajzat dhe djemtë e prekur janë viktimë!**

Për shumë vajza dhe djem, eksperiencat e dhunës seksuale nga moshatarët dhe nga fëmijë më të mëdhenj i ngarkojnë ata së tepërmi. Prandaj, vajzat dhe djemtë që sulmohen seksualisht përkufizohen si viktimë.

Megjithatë, nuk është e drejtë, qoftë nga ana njerëzore, qoftë nga ajo profesionale, që fëmijët që kryejnë sulme seksuale të kriminalizohen si "autorë" apo "autore" dhe që veprimet e tyre të përkufizohen si "abuzim". Prandaj, specialistët flasin për "fëmijë që kryejnë sulme seksuale". Në rutinën e përditshme është e rëndësishme që prindërit e fëmijëve të prekur dhe të atyre që sulmojnë të mos fajësojnë njëri-tjetrin dhe t'i harrojnë fëmijët.

## **Übergriffige Kinder sind keine „Täter“!**

Die Verwendung der Begriffe „Opfer“ und „übergriffige Kinder“ entspricht einem üblichen Sprachgebrauch, der von Opfern ausgeht, ohne zwangsläufig die Verursacher der belastenden Situation als „Täter“ zu bezeichnen. Wenn zum Beispiel ein kleines Mädchen auf dem Spielplatz ein anderes Kind mit dem Rädchen umfährt und dieses sich dabei den Arm bricht, so wird man das betroffene Kind als Unfallopfer bezeichnen. Niemand bezeichnet jedoch die kleine Radfahrerin als „Täterin“.

## **Fëmijët që kryejnë sulme seksuale nuk janë "autorë"!**

Përdorimi i termave "viktimë" dhe "fëmijë që sulmojnë seksualisht" i referohet një ligjërimi të zakonshëm që rrjedh nga viktimat, pa e përkufizuar shkaktarin e situatës së rënduar medoemos si "autor". Për shembull, nëse në një kënd lojërash një vajzë e vogël shtyp me biçikletë një fëmijë tjetër, duke i thyer krahun, fëmija përshkruhet si viktimë aksidenti. Megjithatë, askush nuk e quan vajzën e vogël me biçikletë si "autore".

## **Signale, die Sie beachten sollten!**

Ein Mädchen/Junge...

- hat eine stark sexistische Sprache – stärker, als andere Kinder.
- ist in Doktorspiele mit älteren oder jüngeren Kindern verwickelt,
- versucht, andere Kinder zu Doktorspielen zu überreden,
- verletzt sich selbst oder andere an den Genitalien,
- legt anderen Kindern ein Geheimhaltungsgebot über Doktorspiele auf,
- fordert andere Kinder zu Praktiken der Erwachsenensexualität auf,
- spielt oder spricht über Handlungen, die Erwachsenensexualität entsprechen.

## **Sinjale që duhet t'i merrni parasysh!**

Një vajzë/djalë...

- ka një gjuhë tepër seksiste –më të fortë sesa fëmijët e tjerë.
- në lojën me doktor përziehet me fëmijë më të mëdhenj ose më të vegjël,
- përpiqet t'i bindi fëmijët e tjerë për të luajtur lojëra me doktor,
- lëndon veten ose të tjerët në organet gjenitale,
- u jep fëmijëve të tjerë në urdhër për mbajtje sekreti në lidhje me lojërat me doktor,
- u kërkon fëmijëve të tjerë të bëjnë praktika seksuale si të rriturit,
- luan ose flet për veprime që u përkasin të rriturve.

## **Signale, bei denen Sie sich an eine Beratungsstelle wenden sollten!**

Ein Mädchen/Junge...

- hat an Doktorspielen ein größeres Interesse als an anderen altersgemäßen Spielen und Aktivitäten,
- benutzt eine extrem sexualisierte Sprache und demütigt wiederholt andere Kinder oder Erwachsene mit sexistischen Schimpfwörtern,
- versucht wiederholt, fremde oder uninteressierte Kinder in Doktorspiele einzubeziehen,
- versucht wiederholt, andere Kinder dazu zu überreden, die eigenen Geschlechtsteile oder die anderer Kinder zu berühren.
- fordert wiederholt andere Kinder zu Praktiken der Erwachsenensexualität auf,
- hat kein Verständnis für die Rechte anderer Kinder auf sexuelle Selbstbestimmung,
- verletzt sich selbst oder andere wiederholt oder gezielt an den Genitalien,
- überredet, verführt, besticht oder zwingt andere Kinder mit körperlicher Gewalt oder Drohungen zu Doktorspielen,
- erlegt anderen Kindern unter Anwendung von verbalen Drohungen oder körperlicher Gewalt ein Schweigegebot über sexuelle Handlungen im Rahmen von Doktorspielen auf.

## **Sinjalet që duhet t'ju shtyjnë që të kontaktoni një zyrë konsulence!**

Një vajzë/djalë...

- ka një interes më të madh për lojërat me doktor sesa për lojëra dhe aktivitete të zakonshme për moshën,
- përdor një gjuhë tepër të seksualizuar dhe përul në mënyrë të përsëritur fëmijët ose të rriturit me të shara me përmbajtje seksuale,
- përpiqet vazhdimisht të përfshijë në lojëra me doktor njerëz të panjohur ose fëmijë të painteresuar,
- përpiqet vazhdimisht për t'u mbushur mendjen fëmijëve të tjerë që të prekin organet e veta seksuale ose të fëmijëve të tjerë.
- u kërkon vazhdimisht fëmijëve të tjerë të bëjnë praktika seksuale si të rriturit,
- nuk tregon kuptueshmëri për të drejtat e fëmijëve të tjerë për vetëvendosje seksuale,
- në mënyrë të përsëritur ose me qëllim, lëndon veten ose të tjerët në organet gjenitale,
- bind, josh ose magjepse fëmijët e tjerë për të luajtur lojëra me doktor, nëpërmjet dhunës ose kërcënimeve,
- u vendos fëmijëve të tjerë një urdhër heshtjeje në lidhje me veprimet seksuale në kontekstin e lojërave seksuale, nëpërmjet kërcënimeve verbale ose dhunës fizike.

## Wenn ein Kind sich Ihnen anvertraut...

- Reagieren Sie ruhig und überlegt! Allzu heftige Reaktionen belasten betroffene Kinder.
- Machen Sie keine Vorwürfe, auch wenn Ihr Kind sich Ihnen erst spät anvertraut.
- Loben Sie Ihr Kind, weil sie/er den Mut hatte, darüber zu sprechen.
- Stellen Sie in einem ruhigen Tonfall offene Fragen über den Ablauf der Übergriffe.  
(Zum Beispiel: *Und was ist dann passiert? Was hat xy danach gemacht?*)
- Akzeptieren Sie es, wenn Ihre Tochter/Ihr Sohn nicht (weiter-) sprechen will.
- Überfordern Sie Ihr Kind nicht mit bohrenden Fragen nach Einzelheiten.
- Stellen Sie sachlich fest, dass die Handlungen „nicht in Ordnung“, „blöd“, „gemein“...waren.
- Stellen Sie die Aussagen Ihres Kindes nicht in Frage – auch wenn diese unlogisch sind.
- Diskutieren Sie nicht darüber, ob Ihr Kind etwas falsch gemacht hat. Die Verantwortung für einen sexuellen Übergriff trägt niemals das Opfer!
- Vermeiden Sie Forderungen nach drastischen Strafen für das übergriffige Kind, den Jugendlichen oder Erwachsenen, sonst kann Ihre Tochter/Ihr Sohn sich Ihnen nicht (weiter) anvertrauen!
- Schützen Sie Ihr Kind vor Befragungen in Anwesenheit des übergriffigen Kindes!
- Trösten und pflegen Sie Ihre Tochter/Ihren Sohn!
- Versprechen Sie Ihrem Kind nichts, was Sie nicht halten können!

## Nëse një fëmijë rrëfëhet te ju...

- Reagoni të qetë dhe me maturi! Reagimet tepër të ashpra i rëndojnë fëmijët e prekur.
- Mos bëni akuza, edhe nëse fëmija juaj ju rrëfëhet me vonësë.
- Lëvdojeni fëmijën sepse ka treguar guxim për të folur për sulmet.
- Me ton të qetë, bëni pyetje të hapura në lidhje me mënyrën se si kanë ndodhur sulmet.  
(Për shembull: *pastaj çfarë ndodhi? Çfarë ka bërë pastaj x-i apo y-i?*)
- Pranojeni faktin kur vajza/djali juaj nuk dëshiron të flasë (më tej).
- Mos e rëndoni fëmijën tuaj me pyetje të bezdisshme për hollësira.
- Shprehuni haptazi se veprimet "nuk ishin në rregull", dhe që ishin "trashanike" "të liga"...etj.
- Mos i vini në dyshim thëniet e fëmijës suaj, edhe nëse janë të palogjikshme.

- Mos diskutoni nëse fëmija juaj ka bërë diçka të gabuar. Përgjegjësia për një sulm seksual nuk është asnjëherë e viktimës!
- Evitoni të bëni kërkesa për dënime drastike për fëmijën që kryen sulmin, për të rinjtë ose të rriturit, përndryshe vajza/djali juaj mund të mos vazhdojë t'ju rrëfëhet!
- Mbrojeni fëmijën tuaj nga marrja në pyetje në prani të fëmijës që ka kryer sulmin!
- Ngushëllojeni dhe kujdesuni për vajzën/djalin tuaj!
- Mos i premtoni fëmijës tuaj gjëra që nuk mund t'i mbani!

### **Mein Kind hat sexuelle Übergriffe verübt...**

- Reagieren Sie besonnen! Heftige Reaktionen der Erwachsenen sind zwar menschlich verständlich, lassen jedoch Kinder oft verstummen.
- Vergessen Sie nicht: Übergriffiges Verhalten von Mädchen und Jungen im Vor- und Grundschulalter kann vielfältige Ursachen haben!
- Auch wenn es Ihnen am Anfang schwerfällt, die von Ihrem Kind verübten Übergriffe zu glauben: Hören Sie zu, was andere Kinder über die Handlungen erzählen. Diese Informationen können Ihnen helfen, Ihre Tochter/Ihren Sohn bei der Überwindung des grenzverletzenden Verhaltens zu unterstützen.
- Holen Sie sich die Unterstützung einer Beratungsstelle, die Sie bei Gesprächen begleitet und bei der sachlichen Klärung der Fakten unterstützt.
- Achten Sie darauf, dass Sie im Gespräch mit anderen Müttern und Vätern respektvoll miteinander umgehen.
- Sprechen Sie Ihre Tochter/Ihren Sohn auf die sexuellen Übergriffe an. Benennen Sie die Handlungen ganz konkret, damit das Kind klar versteht, worum es geht.  
*Ich möchte nicht, dass du einen Stock in den Po eines anderen Kindes steckst, am Penis eines anderen Kindes leckst...*
- Vermitteln Sie Ihrem Kind, dass sie/er liebenswert ist, die Handlungen jedoch nicht in Ordnung waren.
- Sagen Sie Ihrem Kind: „Ich will nicht, dass du das machst.“ Sagen Sie Ihrem Kind auch: „Ich halte zu dir, wenn jemand dir weh tut oder dein NEIN nicht respektiert.“
- Fragen Sie Ihr Kind, wer ihr/ihm das beigebracht hat oder wo sie/er so etwas schon einmal gesehen hat.
- Kinder, die *wiederholt* oder *gezielt* sexuell übergriffiges Verhalten zeigen, brauchen therapeutische Hilfe! Pädagogische Maßnahmen reichen nicht!
- Sprechen Sie mit Menschen Ihres Vertrauens! Wählen sie Menschen, die Ihnen gut tun, achtsam mit persönlichen Informationen umgehen und die sexuellen Übergriffe des Kindes weder verharmlosen noch dramatisieren.

- Holen Sie sich therapeutische Unterstützung, falls Sie belastende Fantasien über den Ablauf der sexuellen Übergriffe haben oder wieder an eigene zurückliegende Gewalterfahrungen erinnert werden.

### **Fëmija im ka kryer sulme seksuale...**

- Reagoni në mënyrë të arsyeshme! Është e vërtetë që reagimet e ashpra nga ana e të rriturve janë kuptueshme, por ato shpesh i bëjnë fëmijët të mbyllin gojën.
- Mos harroni: sjellja sulmuese nga ana e vajzave dhe djemve në moshë parashkollore dhe të shkollës fillore mund të ketë disa shkaqe!
- Edhe pse në fillim mund të jetë e vështirë të besoni sulmet e kryera nga fëmija juaj: dëgjoni çfarë thonë fëmijët e tjerë për veprimet. Këto informacione mund t'ju ndihmojnë që të mbështesni vajzën/djalin tuaj në kapërcimin e sjelljes që shkel kufijtë.
- Merrni mbështetje nga një zyrë konsulence, e cila ju shoqëron gjatë bisedave dhe ju mbështet në sqarimin objektiv të fakteve.
- Kini parasysh që, gjatë bisedës me nëna dhe baballarë të tjerë, të silleni me respekt me njëri-tjetrin.
- Flisni me vajzën/djalin tuaj në lidhje me sulmet seksuale. Përmendeni konkretisht veprimin, në mënyrë që fëmija ta kuptojë qartë se përse bëhet fjalë.  
*Nuk dua që ti të fusësh një shkop në prapanicën e një fëmije tjetër, që të lëpish penisin e një fëmije tjetër...*
- Bëjani të qartë fëmijës suaj se atë e keni në zemër, por veprimet nuk ishin në rregull.
- Thoni fëmijës suaj: "Nuk dua që ti ta bësh këtë." Thoni fëmijës suaj edhe: "Qëndroji përkrah teje kur dikush të lëndon ose nuk e respekton JO-në tënde."
- Pyeteni fëmijën tuaj se kush ia ka mësuar asaj/atij ose se ku e ka parë ajo/ai një gjë të tillë.
- Fëmijët, të cilët shfaqin në mënyrë të përsëritur ose të qëllimshme sjellje sulmi seksual, kanë nevojë për ndihmë terapeutike! Masat pedagogjike nuk mjaftojnë!
- Flisni me persona që ju besoni! Zgjidhni persona, të cilët ju bëjnë mirë, dinë të sillen me kujdes me informacione personale dhe që sulmet seksuale të fëmijës nuk i quajnë gjëra të vogla, por as i dramatizojnë.
- Nëse keni fantazi rënduese në lidhje me ecurinë e sulmeve seksuale ose nëse kujtoheni sërish për një sjellje dhune të së kaluarës, atëherë kërkoni mbështetje terapeutike.

## **Kindern bei der Verarbeitung sexueller Übergriffe helfen...**

Die Folgen sexueller Übergriffe durch andere Kinder oder Erwachsene müssen ernst genommen werden. Nach einem ersten Schock verarbeiten viele Mädchen und Jungen weniger massive sexuelle Übergriffe meist ohne sehr belastende Langzeitfolgen – vorausgesetzt: Es wird ihnen geglaubt und sie werden vor weiteren Übergriffen geschützt.

Mädchen und Jungen reagieren auf sexuelle Gewalterfahrungen häufig mit zeitlicher Verzögerung. Das bedeutet: Die Folgen der Gewalterfahrungen werden oftmals erst Wochen oder Monate später deutlich. Nicht selten erkennen Eltern und pädagogische Fachkräfte nicht den Zusammenhang und betroffene Kinder bleiben ohne Hilfe.

## **Mbështetja ndaj fëmijëve për të tejkaluar sulmet seksuale...**

Sulmet seksuale të mëposhtme nga fëmijë të tjerë ose të rritur duhet të merren seriozisht. Pas shokut të parë, në shumicën e rasteve shumë vajza dhe djem i tejkalojnë sulmet seksuale më pak masive pa pasoja afatgjata shumë rënduese – më kusht që: të tjerët ta besojnë historinë e tyre dhe të mbrohen ndaj sulmeve të mëtejshme.

Shpesh vajzat dhe djemtë reagojnë ndaj eksperiencave të dhunës seksuale me një vonesë në kohë. Kjo do thotë: shpesh, pasojat e eksperiencave të dhunës bëhen të qarta pas disa javësh ose muajsh. Jo rrallë, prindërit dhe personeli pedagogjik nuk e dallojnë kontekstin dhe fëmijët e prekur mbeten pa ndihmë.

Beratungsstellen gegen sexuellen Missbrauch oder Fachberatungsstellen geben Ihnen Tipps, wie Sie die Selbstheilungskräfte Ihres Kindes stärken können. Sie klären mit Ihnen, ob eine traumatherapeutische Hilfe für Ihr Kind notwendig und hilfreich ist oder nicht.

Die folgenden Tipps helfen Eltern, ihren Kindern eine kindgerechte Begleitung bei der Bewältigung sexueller Übergriffe zu geben.

- Verzweifeln Sie nicht, wenn Ihr Kind in den ersten Wochen massive Auffälligkeiten zeigt!  
*Viele Kinder leiden zunächst unter massiven Folgen: Ängste, nächtliche Schreianfälle, Wutanfälle, Albträume, Freudlosigkeit, körperliche Reaktionen, Babyverhalten und –sprache.... Einige Wochen später geht es ihnen meist wieder besser.*
- Zeigt Ihre Tochter/Ihr Sohn körperliche Reaktionen und Gefühlsschwankungen, so erklären Sie diese auf eine kindgerechte Art und Weise.

- Dir ist ganz kalt, weil du jetzt wieder daran denken musst. ...*
- Pflegen Sie das Mädchen/den Jungen, wenn sie/er unter schmerzhaften Körpererinnerungen leidet (z.B. Fieber, Bauch- und Kopfschmerzen und schwere Arme und Beine).  
*Opfer brauchen bei schmerzhaften Körpererinnerungen eine liebevolle Pflege – ähnlich wie Kinder nach schweren Operationen.*
  - Behalten Sie im Blick, ob, wann und wo Ihre Tochter/Ihr Sohn Folgen zeigt.  
*Die Belastungen kindlicher Opfer werden häufig erst nach mehreren Wochen oder Monaten deutlich. Einige Mädchen und Jungen wechseln zwischen symptomreichen und symptomfreien Zeiten oder wirken im Elternhaus sehr belastet, in der Kita oder Schule jedoch „völlig normal“ – bzw. umgekehrt.*
  - Falls Ihr Kind unter Stimmungsschwankungen leidet (plötzliche Unruhe/Übererregung, Traurigkeit, Wutanfälle...), achten Sie darauf, was kurz vor diesen Stimmungsschwankungen geschehen ist.
  - Viele betroffene Mädchen und Jungen verlieren sich immer mal wieder in schmerzhaften Erinnerungen oder wirken wie abwesend, schauen zum Beispiel „durch einen durch“. Unterbrechen Sie solche Zustände. Ist ein Kind trotz ruhiger und klarer Ansprache nicht erreichbar, so hilft oft Singen, in den Arm nehmen oder Bewegung.
  - Reagieren Sie mit einer liebevollen Sachlichkeit, wenn Ihr Kind Einzelheiten über die belastenden Erlebnisse erzählt.  
*Das war wirklich doof für dich! ... Wenn ich das gewusst hätte, hätte ich dir sofort geholfen...*
  - Sprechen Sie Ihr Kind nicht vor dem Einschlafen auf die sexuellen Übergriffe an!  
*Spielen Sie vor dem Einschlafen eine schöne Musikkassette oder lesen Sie eine Gutenachtgeschichte vor.*
  - Akzeptieren Sie es, wenn Ihr Kind zunächst bestimmte Situationen vermeidet. Helfen Sie jedoch, dieses Vermeidungsverhalten wieder schrittweise aufzugeben.  
*Falls Ihre Tochter/Ihr Sohn Ängste vor Kindergruppen entwickelt, geben Sie Ihr Kind vorübergehend nur für eine begrenzte Zeit in die Kita.*
  - Geben Sie Ihrem Kind durch eine klare und beständige Tagesstruktur eine Orientierung.
  - Reduzieren Sie Ihr Kind nicht auf die Opferrolle! Ein ganz normaler Alltag tut gut!
  - Altersentsprechende Grenzen und klare Regeln vermitteln betroffenen Mädchen und Jungen ein sicheres Gefühl.
  - Finden die Übergriffe in einer Kita/in der Schule/in einer Unterkunft statt, so prüfen Sie, ob die Pädagoginnen und Pädagogen den Schutz Ihres Kindes sicherstellen können und bereit sind, mit einer Beratungsstelle zu kooperieren.
  - Tauschen Sie sich mit Menschen Ihres Vertrauens aus. Vermeiden Sie jedoch allzu häufige Problemgespräche. Es hilft weder Ihnen

noch Ihrem Kind, wenn sich „alles nur noch um die sexuellen Übergriffe dreht“.

- Falls Sie selber ständig an die Übergriffe denken müssen, sich belastende Fantasien über den Ablauf der Übergriffe machen oder massiv mit eigenen belastenden Vorerfahrungen beschäftigt sind, sollten Sie nicht nur für Ihr Kind, sondern auch für sich selbst Beratung suchen.  
Traumafachberater/innen können Ihnen Möglichkeiten aufzeigen, wie Sie selbst belastende Erinnerungen und Fantasien stoppen können.
- Vergessen Sie nicht sich selbst und Ihre Partnerschaft!

Zyrat e konsulencës kundër abuzimit seksual ose zyrat e specializuara të konsulencës ju japin këshilla mbi mënyrën se si mund t'i forconi forcat vetëshëruese të fëmijës suaj. Zyrat diskutojnë dhe vendosin bashkë me ju nëse një ndihmë terapeutike për fëmijën tuaj do të ishte e nevojshme dhe e dobishme ose jo.

Këshillat e mëposhtme i ndihmojnë prindërit për t'u dhënë fëmijëve të tyre një shoqërim të përshtatshëm për ta gjatë parandalimit të sulmeve seksuale.

- Mos u hutoni nëse fëmija juaj shfaq anomali të mëdha gjatë javëve të para!  
*Fillimisht, shumë fëmijë vuajnë nga pasoja të mëdha: ankthe, të bërtitura gjatë natës, momente zemërimi, makthe, humbje kënaqësie, reagime trupore, sjellje dhe të folur si foshnje.... Pas disa javësh, zakonisht bëhen më mirë.*
- Nëse vajza/djali juaj shfaq reagime trupore dhe luhatje ndjenjash, atëherë duhet t'ua shpjegoni atyre në një mënyrë që është e përshtatshme për fëmijët.  
*Ke ftohtë sepse duhet të mendosh sërish për këtë....*
- Kujdesuni për vajzën/djalin nëse ajo/ai vuan nga kujtime trupore të dhimbshme (p.sh. ethe, dhimbje barku dhe koke dhe rëndim krahësh dhe këmbësh).  
*Në rast kujtimesh të dhimbshme trupore viktimat kanë nevojë për përkujdesje plot dashuri – ngjashëm si fëmijët pas operacioneve.*
- Vini re nëse, kur dhe ku vajza/djali juaj shfaq pasoja.  
*Vështirësitë e viktimave fëmijë shpesh dalin në pah pas disa javësh ose muajsh. Disa vajza dhe djem përjetojnë periudha kohore plot me simptoma ose pa simptoma ose në shtëpinë e prindërve shfaqin shumë vështirësi, ndërsa në qendër ditore ose në shkollë ata sillen "plotësisht normalë" – ose anasjelltas.*
- Nëse fëmija juaj vuan nga luhatje humori (shqetësime të papritura/mbinxehje, mërzitje, momente zemërimi...), vini re çfarë ka ndodhur para këtyre luhatjeve të humorit.
- Shumë vajza dhe djem të prekur humbasin herëpashere në kujtime të dhimbshme ose sillen sikur të mos jenë të pranishëm, shikojnë,

për shembull, "dikë përtej". Ndërpritni gjendje të tilla. Nëse fëmija juaj nuk mund të arrihet, megjithëse i flisni qartë, atëherë shpesh mund të ndihmojë nëse këndoni bashkë me të, i merrni në krahë ose lëvizni.

- Reagoni me një objektivitet plot dashuri, kur fëmija juaj ju tregon eksperiencën që i rëndojnë.

*Kjo ishte vërtet diçka e keqe që të ka ndodhur! ...Sikur ta kisha ditur, do të të kisha ndihmuar menjëherë...*

- Mos flisni me fëmijën tuaj për hollësi në lidhje me sulmet seksuale!  
*Para se të flejë, vini një kasetë të bukur ose lexoni një histori për ta vënë në gjumë.*
- Pranojeni nëse fillimisht fëmija juaj eviton situata të caktuara. Megjithatë, ndihmojeni për të hequr dorë gradualisht nga këto sjellje.  
*Nëse vajza/djali juaj zhvillon frikë nga grupe fëmijësh, dërgojeni fëmijën tuaj në qendër ditore, përkohësisht, vetëm për një kohë të kufizuar.*
- Jepini fëmijës suaj një orientim nëpërmjet një strukture ditore të qartë dhe konstante.
- Mos e reduktoni fëmijën tuaj në rolin e viktimës! Një rutinë e përditshme normale bën mirë!
- Kufij të përshtatshme për moshën dhe rregulla të qarta u japin vajzave dhe djemve një ndjenjë të sigurt.
- Nëse sulmet në një qendër ditore/në shkollë ndodhin në një strehimore, atëherë kontrolloni nëse pedagogia ose pedagogu mund të sigurojë mbrojtjen e fëmijës suaj dhe nëse janë të gatshëm të bashkëpunojnë me një zyrë konsulence.
- Bëni shkëmbime eksperiencash me njerëz që u besoni. Megjithatë, evitoni biseda të shpeshta për probleme. Nuk ju ndihmon as ju, as fëmijën tuaj, nëse "çdo gjë sillet vetëm rreth sulmeve seksuale".
- Nëse juve vetë ju duhet të mendoni vazhdimisht për sulmet, mendoni fantazi në lidhje me ecurinë e sulmeve ose jeni të zënë shumë me eksperiencën të vështira personale, duhet të kërkonte konsulentë jo vetëm për fëmijën tuaj, por edhe për vete. Specialiste/specialistë traumash mund t'ju tregojnë mundësi në lidhje me mënyrën se si mund t'i ndaloni kujtimet dhe fantazitë që ju rëndojnë.
- Mos harroni vetën tuaj dhe partneritetin tuaj!